



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar me datë	03.04.2019
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	01-123

SENATI

Rruga e Shkronjave Nr.1, 20000 Prizren - Kosovë; Tel.+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Prizren, 15.03.2019

Duke u bazuar në nenin 48, paragrafi 1.9. të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, duke vendosur në lidhje me miratimin e Rregullores për themelimin dhe parimet e funksionimit të Bordit Këshillëdhënës Industrial të Njësive Akademike të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, Senati i UUH-së në mbledhjen e mbajtur më datë: 15.03.2019, mori këtë:

V E N D I M


- I. Miratohet Rregullorja për themelimin dhe parimet e funksionimit të Bordit Këshillëdhënës Industrial të Njësive Akademike të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.
- II. Pjesë përbërëse e këtij vendimi do të jetë edhe Rregullorja e sipërshënuar.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në momentin e miratimit të tij, ndërsa rregullorja e lartcekur hyn në fuqi 7 ditë pas nënshkrimit nga kryesuesi i Senatit të UUH-së.

Vendimi i dërgohet:

Menaxhmentit
Njësive akademike
Sekretarit të Përgjithshëm
Arkivit

Kryesues i Senatit të UUH-së

Prof. asoc. dr. Ismet Temaj





Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

SENATI

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Prizren, më: 15.03.2019

Duke u bazuar në nenin 48, paragrafi 1.9. të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, Senati në mbledhjen e mbajtur më 15.03.2019, miraton Rregulloren për themelimin dhe parimet e funksionimit të Bordit Këshillëdhënës Industrial të Njësive Akademike të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.

Rregullorja për themelimin dhe parimet e funksionimit të Bordit Këshillëdhënës Industrial të Njësive Akademike të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren.

Qëllimi i Bordit Këshillëdhënës Industrial

Qëllimi i themelimit të Bordit Këshillëdhënës Industrial është bashkëpunimi dhe ndërveprimi ndërmjet njësive akademike dhe komunitetit industrial. Kjo rregullore përcakton karakterin, anëtarësimin, funksionimin, fushëveprimin, mënyrën e vendimmarrjes dhe mandatin e Bordit Këshillëdhënës Industrial.

Neni 1.

Karakterit i Bordit Këshillëdhënës Industrial

1. Karakteri i Bordit Këshillëdhënës Industrial (në tekstin e mëtejme BKI), të themeluar në bazë të Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren (në tekstin e mëtejme UUHP) dhe të kësaj Rregulloreje, *është jo fitimprurës dhe këshillëdhënës* dhe bazohet në vullnetin e mirë të anëtarëve dhe përkushtimin e njësive akademike (në tekstin e mëtejme NjA) dhe UUHP-së për ngritjen e cilësisë së Arsimit të Lartë në fushën e veprimtarisë së NjA-së.
2. BKI përbëhet nga përfaqësuesit e tregut të punës dhe të autoriteteve nga fushëveprimtaria e NjA-së përkatëse, dhe përfaqësues të studentëve të NjA-së përkatëse.
3. Anëtarët e BKI-së (përveç anëtarëve ex-officio, dhe atyre që janë angazhuar paraprakisht) nuk mund të angazhohen si ligjërues në NjA-në, pasi të nominohen si anëtarë të BKI-së.
4. Secili anëtarë i BKI-së (përfaqësues i tregut të punës) që do të shërbejë në BKI të NjA-së, do të nënshkruajë Memorandumin e Mirëkuptimit, me ç'rast siguron gatishmërinë e tij/saj për të

shërbyer në BKI në baza vullnetare, pa pritur ndonjë shpërblim, duke eliminuar konfliktin e interesit dhe ruajtur konfidencialitetin e informatave.

5. Themelimi i BKI-së në secilën njësi akademike të UUHP është i obligueshëm për të siguruar se programet studimore janë në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe monitoruar rezultatet performancës së programeve të propozuara studimore tek të diplomuarit në këto programe.
6. Përbërja dhe aktivitetet e BKI-së publikohen në ueb faqen e UUHP-së në vegzën e NjA-së. Secila NjA e UUHP-së duhet të zhvillojë një vegzë të veçantë në ueb-faqen e NjA-së, për të publikuar aktivitetet e BKI-së.

Neni 2.

Themelimi i BKI-së

1. BKI-në e themelon NjA-ja përkatëse me propozimin e Dekanit.
2. Dekanët e NjA-së i propozojnë anëtarët e BKI-së, emërimin e të cilëve e miraton Këshilli i NjA-së.
3. Dekani i NjA-së përgatitë mbledhjen konstitutive të BKI-së, përpilon materialet lidhur me rendin e ditës dhe ndërmerr aktivitete tjera për mbarëvajtjen e punës së BKI-së .
4. Pas konstituimit të BKI-së dhe zgjedhjes së kryetarit/res të BKI-së, mund të propozohen edhe anëtarë tjerë të BKI-së. Për zgjedhjen e tyre, dekani e informon Këshillin e NjA-së.

Neni 3.

Anëtarësia e BKI-së

1. BKI mund të ketë minimum 11 (njëmbëdhjetë) anëtarë deri maksimum 17 (shtatëmbëdhjetë) anëtarë. Numri i anëtarëve duhet të jetë tek dhe së paku 65% e anëtarëve të BKI-së duhet të jenë nga tregu i punës.
2. BKI përbëhet nga përfaqësues të tregut të punës që janë udhëheqës/vendimmarrës në kompani private apo publike si dhe përfaqësues të autoriteteve qeveritare relevante për fushë-veprimtarinë e NjA-së përkatëse, dhe një student i regjistruar në NjA, me sukses të dalluar akademik, dhe së paku të jetë në semestrin e tretë të studimeve.
3. Anëtarë *ex-officio* të BKI-së janë Dekani/ja, Prodekanët dhe Sekretari/ja i/e NjA-së, si dhe mund të jetë një përfaqësues nga Universiteti ose ndonjë prej fakulteteve me fushëveprim të ngjashëm. BKI-ja mund të ketë jo më shumë se 4 (katër) anëtarë *ex-officio* të cilët janë pjesë e BKI-së, pa të drejtë vote.
4. Të gjithë anëtarët e interesuar duhet të jenë të përkushtuar që të shërbejnë në mënyrë aktive dhe profesionale konform mandatit dhe pozitës së tyre në BKI, së paku dy vjet.
5. Anëtarët e BKI-së duhet të jenë besnik ndaj misionit të UUHP, të jenë entuziast për të kontribuar në NjA në baza vullnetare, të kenë integritet personal dhe profesional, të përgjegjshëm, të kenë njohuri dhe aftësi rreth fushës së programeve studimore të NjA-së përkatëse, të kenë qasje në burime të informatave që janë përfituese për NjA-në; të ofrojnë

informata kthyesë për kërkesat e tregut të punës, të ndajnë eksperiencat e tyre dhe të shprehin interes të zhvillojnë programe të reja;

Neni 4. Struktura e BKI-së

1. BKI e zgjedh Kryetarin/en dhe zëvendës kryetarin/en nga radhët e përfaqësuesve të tregut të punës. Kryetari/ja i/e BKI-së udhëheq mbledhjet dhe kujdeset që informatat lidhur me mbledhjet të shpërndahen të të gjithë anëtarët e vet dhe palët tjera të interesit sipas nevojës.
2. Kryetari/ja i/e BKI-së e përfaqëson BKI-në në raport me palën e tretë. Në mungesë të kryetarit/es, zëvendës kryetari/ja merr përsipër përfaqësimin e BKI-së.
3. Kryetari/ja i/e BKI-së prezanton punën e BKI-së në organizime të ndryshme, si: Këshilli i NjA-së, institucionet e arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit, punëtori tematike etj.
4. Mandati i Kryetarit/es të BKI-së është 2 (dy) vjeçar, me mundësi të ri-zgjedhjes në mandatin e dytë. Kryetari/ja mund të shërbejë vetëm në 2 (dy) mandate 2 (dy) vjeçare.
5. Mandati i zëvendës kryetarit/es të BKI-së është 3 (tre) vjeçar. Zv. Kryetari/ja mund të shërbejë vetëm një mandat
6. BKI mund të formojë grupe punuese që përqendrohen në lëmi të veçanta të fushëveprimit të NjA-së përkatëse të tregut të punës.
7. Varësisht nga temat për diskutim, në mbledhjet e BKI-së mund të ftohen shefat e departamenteve dhe përfaqësues të organeve përkatëse që funksionojnë në kuadër të NjA-së, pa të drejtë vote.

Neni 5. Procedura e përzgjedhjes së strukturave të BKI-së

1. Zgjedhja e Kryetarit/es dhe zëvendës kryetarit/es bëhet me votim të fshehtë.
2. Krijohet komisioni prej 3 anëtarëve të BKI-së, dy anëtarë të cilët nuk janë të interesuar të nominohen dhe sekretari/ja. Nëse të gjithë anëtarët e BKI-së nominohen atëherë komisioni mund të përbëhet prej: Dekanit/es, prodekanit/es dhe sekretarit/es.
3. Anëtarët e BKI-së mund të nominojnë vetën apo ndonjë anëtarë tjetër që dëshiron të nominohet.
4. Nominimi bëhet duke e plotësuar formularin për nominim (Shtojca I.) që përmban: emrin e personit, aryeja pse e nominoni, si do të kontribuojë në BKI, dhe cilësitë e personit të nominuar.
5. Formulari i plotësuar i nominimit duhet të dërgohet përmes shkresës zyrtare ose e-mailit të dekani/ja i/e NjA-së, 3 ditë para se të mbahet takimi përzgjedhës.
6. Në takimin përzgjedhës, duhet të jenë të pranishëm së paku 50% +1 anëtarëve që kanë të drejtë vote dhe kanë nënshkruar marrëveshjen e mirëkuptimit me NjA-në përkatëse.
7. Sekretari/ja e NjA-së përkatëse përgatitë fletë-votimet me emrat e të gjithë anëtarëve të nominuar.

8. Të gjithë anëtarët e pranishëm votojnë vetëm për një anëtar të nominuar.
9. Komisioni numëron dhe shpall votat e anëtarëve.
10. Anëtari/ja i/e nominuar që ka marr numrin më të madh të votave përzgjidhet kryetar/e i/e BKI-së, ndërsa anëtari/ja i/e dyti/a me radhë për nga numri i votave përzgjidhet zëvendës kryetar/e.
11. Në rast se dy ose më shumë anëtarë kanë numër të barabartë të votave, atëherë votimi përsëritet duke votuar vetëm anëtarët që kanë numrin e barabartë të votave.

Neni 6.

Roli dhe përgjegjësitë e anëtarëve të BKI-së

1. BKI mund t'i sugjerojë Këshillit të NjA-së përditësimin e programeve të studimeve, për të siguruar që studentët marrin përgatitjen e duhur profesionale në përputhje me kërkesat e tregut.
2. Anëtarët e BKI-së mund të mbështesin realizimin e praktikës profesionale të studentëve të NjA-së, në pajtim me programet e studimeve dhe mund të vlerësojnë rezultatet e të nxënit të studentëve, nëse kërkohet.
3. Trupa këshillëdhënëse mbështet NjA-në dhe tregun e punës të fushë veprimtarisë respektive në krijimin e grupeve të përbashkëta punuese.
4. Trupa këshillëdhënëse dhe NjA bashkëpunojnë në kërkime shkencore, shërbime profesionale, bashkëpunime në projekte, ndërmjetësim për inovacione, si dhe në propozime për bashkëpunim në projekte të përbashkëta me NjA-në dhe partner të tjerë.
5. Anëtarët e BKI-së mund të jenë mysafirë folës për NjA-në përkatëse, ofrojnë bursa për studentë si dhe përkrahje financiare për projekte hulumtuese të studentëve dhe stafit akademik.
6. Anëtarët e BKI-së mund të jenë anëtarë të komisionit për shpërndarjen e bursave për studentë dhe/ose vlerësojnë arritshmërinë e studentëve nëse një gjë e tillë kërkohet nga Njësia Akadematike
7. BKI varësisht prej veprimtarisë së NjA-së mund të shqyrtojë edhe çështje tjera të propozuara nga Dekani.

Neni 7.

Organizimi i takimeve të BKI-së

1. BKI në njësinë akademike duhet të mbajnë takime sipas nevojës, por jo më pak se 2 (dy) takime në vit.
2. Për tu mbajtur takimi duhet të ketë kuorum, më shumë se gjysma e anëtarëve të BKI-së duhet të jenë prezent.
3. Takimet mund të thirren nga cilido anëtarë i BKI-së duke dërguar një kërkesë me shkrim (e-mail) tek Kryetari/ja i/e TK-së dhe specifikuar çështjen për të cilën thirret takimi.
4. Kryetari/ja i/e BKI-së pas konsultimit me dekanin e NjA-së e thirrë takimin e BKI-së.

5. Nëse kryetari/ja dështon të organizoj takimet e BKI-së dhe/ose mungon në dy mbledhje radhazi atëherë BKI duhet të shpall zgjedhjet për kryetar/e.
6. Për secilin takim duhet cekur datën dhe vendin e takimit, dërguar agjendën e takimit e cila do t'ju shpërndahet të gjithë anëtarëve të BKI-së së paku 7 ditë para datës në të cilën do të mbahet takimi.
7. Ftesa për takimin e BKI-së duhet të dërgohet nga sekretari/ja i/e NjA-së në emër të kryetarit/es të BKI-së.
8. Kryetari/ja i/e BKI-së në bashkëpunim me dekanin/en i/e NjA-së, raportojnë në zyrën e për sigurimin e cilësisë të rektoratit të UUPH-së për takimet e mbajtura.
9. Për secilin takim duhet të mbahet procesverbali, lista dhe vendimet që janë marrë nga BKI-ja.
10. Për të siguruar mbarëvajtjen e takimeve të BKI-së, dekani i NjA-së, emëron sekretarin/ren e NjA-së, i/e cili/a përveç që është anëtar/e, do të jetë përgjegjës dhe ofrojë mbështetje Kryetarit/es të BKI-së.
11. Sekretari/ja e NjA-së është përgjegjës/e për organizimin e takimeve të BKI-së, përkujdeset për përmbledhjen e raporteve të punës së BKI-së të njësisë akademike, arkivimin e dokumenteve dhe vendimeve, operacionalizimin e iniciativave të tij, publikimin e aktiviteteve të BKI-ve në vegzën e NjA-së të ueb faqes së UUHP-së, dhe aktivitete tjera që konsiderohen të nevojshme për të funksionalizuar BKI-të dhe promovuar punën e BKI-ve.

Neni 8.

Propozimet e BKI-së

1. BKI mund të sugjerojë ndryshimin, përmirësimin dhe amandamentimin e rregulloreve të UUHP-së dhe akteve tjera në fuqi.
2. BKI mund t'i propozojë Këshillit të NjA-së programe që kanë të bëjnë me: mësim tërë-jetësor, aftësimin e të rriturve dhe trajnime profesionale.
3. BKI bënë vlerësime, rekomandime e sugjerime lidhur me kushtet e punës, laboratorët dhe lehtësimin e funksionalizimit të punës.
4. Këshillat dhe sugjerimet e BKI-së për çështjet e trajtuara, do t'i adresohen Këshillit të NjA-së, Senatit të UUHP-së, menaxhmentit dhe Këshillit Drejtues të UUHP-së, në kuadër të: hartimit të programeve të reja, aplikimit për proces të akreditimit, caktimit të punës praktike, planifikimit projekteve kërkimore-shkencore, vlerësimit të tyre, hartimit të dokumenteve strategjike, etj.

Neni 9.

Miratimi i propozimeve të BKI-së

1. Miratimi i propozimeve në BKI-së bëhet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm.
2. Rekomandimet e BKI-së, në formë të propozimit dorëzohen në Këshillin e NjA-së për procedim të mëtutjeshëm.
3. Këshilli i NjA-së duhet të shqyrtojë kërkesat dhe propozimet për ndryshime të programeve akademike apo për programe të reja dhe kthejnë përgjigje me arsyetim për vendimin e marrur, te kryetari/ja i/e BKI-së, në afat prej 30 ditëve.

Neni 10.

Mandati i anëtarëve të BKI-së

1. Mandati i anëtarëve të BKI-së zgjat 2 (dy) vite, me mundësi të rizgjedhjes për një mandat tjetër, bazuar në interesin e anëtarëve dhe kontributin e dhënë për NjA-të.
2. Anëtarësimi në BKI është i hapur pa marrë parasysh racën, gjininë, orientimin seksual, shtetësinë, kombësinë, religjionin, moshën ose aftësitë fizike.
3. Me ftesën e Dekanit, Kryetari i BKI-së mund të prezantojë para Këshillit të NjA-së dhe para Agjencionit të Kosovës për Akreditim (AKA) aktivitetet e BKI-së për periudhën e caktuar, apo kërkesat për programe të reja studimore apo përmirësimin e programeve ekzistuese.
4. Në rastin e akreditimit dhe ri-akreditimit të programeve të studimeve, nëse Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA), kërkon takim me Kryetarin e BKI-së, kryetari i BKI-së do të takohet me ekspertët e AKA-së pas konsultimit me menaxhmentin e NjA-së.
5. Mandati i anëtarëve të BKI-ve që janë themeluar me rregulloren e miratuar më datë 29.12.2014, do të mbetet 4 (katër) vjet, me mundësi të ri-zgjedhjes edhe për një mandat tjetër 2 (dy) vjeçar.

Neni 11.

Largimi apo suspendimi i anëtarëve të BKI-së

1. Mandati i anëtarëve mund të përfundojë ose suspendohet me vendimin e BKI-së në rast se:
 - nuk respektojnë vendimet e Universitetit.
 - nuk marrin pjesë në mënyre aktive në punën e BKI-së,
 - mungojnë në 2 (dy) mbledhje radhazi.
 - nuk sillen në përputhje me dispozitat e kësaj rregullore dhe rregulloret tjera të UUHP-së,
 - nuk veprojnë në përputhje me Kodin e Etikës të Universitetit,
 - nuk respektojnë vendimet e BKI-së.
2. Në rast të suspendimit, kohëzgjatja e suspendimit do të përcaktohet nga anëtarët e BKI-së
3. Përfundimi ose suspendimi i anëtarësimit nga BKI-ja do të vendoset me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të BKI-së prezent.

Neni 12

1. Udhëzimin mbi funksionim e kësaj rregulloreje e nxjerr Njësia Akademike respektive.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi 7 ditë pas nënshkrimit nga kryesuesi i Senatit të UUHP-së.

Kryesues i Senatit të UPZ-së

Prof. asoc. dr. Ismet Temaj



Shtojca 1. Formulari për nominimin e kryesuesit të Bordit Këshillëdhënës Industrial



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren
University "Ukshin Hoti" Prizren

Formulari për nominimin e Kryesuesit të Trupës Këshillëdhënëse

Emri i anëtarit të BKI-së	
Emri i anëtarit të nominuar	
Cilësitë e anëtarit të nominuar	
Arsyeja e nominimit - Si mund të kontribuoj ky/kjo anëtar/e në BKI?	